



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1743/8 Prot

Tiranë, më 20.12.2023

VENDIM

Nr.71, datë 20. 12. 2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Tenius Laboratories Sh.p.k, përfaqësuar nga znj. (në vijim quajtur “Ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1743 Prot., datë 26.10.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Mjedisit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesave të datës 04.09.2023 dhe 22.09.2023, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni lidhur me:

1. Kopje të raporteve të vetmonitorimit të subjektit Eko Elb sh.a për 5 vitet e fundit.
2. Cili është laborator, i cili ka kryer analizat në terren dhe në laborator?
3. A ka qenë ky laborator i akredituar për analizimin e parametrave?
4. Në cilat data janë kryer matjet në terren?
5. A ka ushtruar Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndonjë kontroll tek ky subjekt?

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 7135/1 Prot., datë 15.09.2023 i ka kthyer përgjigje ankueses duke cituar se: “...Subjekti Eco-Elb Sh.a, ka dorëzuar Raportet e Vetëmonitorimit

për periudhat: Shtator - Dhjetor 2022, Dhjetor 2022 – Mars 2023 nga studio Qendra e Monitorimit të Mjedisit (QMM) dhe Mars – Qershor 2023 nga studio Eko-Studio Projekt. Referuar faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezulton se laboratorët që kanë kryer analizat janë të akredituar me Nr. Regjistrimi QMM-LT 096 dhe ESP me Nr. Regjistrimi LT 070. Sa i përket pikës 4, matjet janë kryer në datat 01.12.2022, 07.03.2023 dhe 19.06.2023. Në lidhje me pikën 5, nga verifikimi në sistemin “E-Inspketimi”, rezulton të jenë ushtruar kontrolle për sa i përket Lejes Mjedisore që subjekti disponon.”

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i plotë sipas objektit të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr.1743/1Prot., datë 31.10.2023, kërkoi nga Autoriteti Publik, qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 07.11.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 9249 Prot., datë 06.11.2023 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Megënëse në fund të raporteve të vetmonitorimit citohet se këto raporte analitike nuk mund të kopjohen/publikohen qoftë edhe pjesërisht pa autorizimin me shkrim të studiove private të akredituara dhe të licencuara, i është drejtuar këtyre të fundit që kanë hartuar raportet e vetmonitorimit, duke kërkuar miratimin për nxjerrjen e dokumentacionit.*”

Në vijim, me emailin e datës 08.11.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1743/2 Prot., datë 09.11.2023, ankuesja ka vijuar ankimin duke kërkuar nga Komisioneri urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Me shkresën nr. 9249/3 Prot., datë 15.11.2023, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Qendra e Monitorimit të Mjedisit me shkresën nr. 600 Prot., datë 08.11.2023*

ka refuzuar dhënien e informacionit. Eko-Studio Projekt me shkresën nr.935Prot., datë 14.11.2023 nuk ka miratuar nxjerrjen e dokumentacionit të kërkuar.”

Në vijim, me emailin e datës 20.11.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1743/7 Prot., datë 21.11.2023, ankuesja ka vijuar ankimin duke kërkuar urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga Autoriteti Publik lidhur me pikën e parë të kërkesës për informacion të datës 04.09.2023.

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 190, datë 14.11.2023, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, duke filluar nga data 17.11.2023. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 9602 Prot., datë 17.11.2023.

Gjatë inspektimit, u kontaktua me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, e cila sqaroi se: *“Pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është depozituar shkresa Nr.40 Prot., datë 04.09.2023, protokolluar me Nr. 7135 Prot., datë 06.09.2023. Këtë kërkesë e kam përcjellë me e-mailin e datës 06.09.2023 znj. Marjeta Përlala, Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, Z. Neritan Postoliti Drejtor i Drejtorisë së Regjistrave Mjedisore Inovacionit dhe Analizave Laboratorike si dhe Z. Kejdi Ahmetaj Përgjegjës në Drejtorinë e Inspektim Kontrollit. Me shkresën Nr.7135/1 prot datë 15.09.2023, kërkueses në fjalë i është kthyer përgjigje nga Drejtoria e Lejeve Mjedisore dhe VNM-së (Pranoi M. Përlala),si dhe e-mail nga Drejtoria e Inspektimit (K. Ahmetaj) lidhur me pikën 5 të kërkesës. Në datë 22.09.2023 me Nr.41 prot, protokolluar në AKM me Nr.7135/2 prot., datë 26.09.2023, znj. kërkon që në informacion të përfshihet edhe aktiviteti i impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhim të energjisë.*

Për kërkesën në fjalë, pas konsultimit me Drejtoreshën Marjeta Përlala, Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, AKM i ka kthyer përgjigje kërkueses me e-mailin e datës 01.11.2023, duke i bërë të ditur se: “Në vijim të informacionit të kërkuar, AKM ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.7135/1 prot datë 15.09.2023. Në lidhje me pyetjen nr. 1 “Kopje të raporteve të vetmonitorimit”, AKM i ka komunikuar periudhat e raportimit ndërsa Raporti i Vetmonitorimit hartohet nga studio private të akredituara dhe të licensuara, konform nenit 17, pika c e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit”, lutemi ti drejtoheni subjektit ose studiove përkatëse për të marrë pëlqimin paraprak të tyre. Studio në fjalë në fund të raporteve përshkruajnë që “këto raporte analitike nuk mund të kopjohen/publikohen qoftë edhe pjesërisht pa autorizimin me shkrim të tyre”. Me e-mailin e datës 02.11.2023, znj. ka insistuar në informacionin e kërkuar. Në këto kushte AKM i është drejtuar me e-mailin e datës 02.11.2023 studiove të vetmonitorimit dhe subjektit EKO ELB për konfirmimin e pëlqimit të kërkesës në fjalë. Kërkuesja në fjalë ka ushtruar ANKIM pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili

me shkresën Nr.1743/I prot datë 31.10.2023 protokolluar në AKM me shkresën nr.7135/3 prot datë 01.11.2023. ANKIMI në fjalë i është përcjellë Drejtoris përkatëse për trajtim me e-mailin e datës 02.11.2023. Me Shkresën Nr. 9249 Prot datë 15.11.2023 i jemi drejtuar laboratorëve Qendra e Monitorimit të Mjedisit dhe Eko Studio Projekt si edhe Shoqërisë “Eco-Elb” Sha për të dhënë dakordësin lidhur me dhënien e raporteve të vetëmonitorimit. QMM –Qendra e Monitorimit të Mjedisit ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.600 prot datë 8.11.2023 protokolluar në AKM me nr.9249/1 prot 09.11.2023 ka refuzuar dhënien e informacionit. Edhe Eko Studio Projekt me shkresën Nr.935 prot datë 14.11.2023 protokolluar në AKM 9249/2 prot datë 14.11.2023 ka refuzuar pëlqimin për dhënien e informacionit. Ndodhur në këto kushte, AKM me shkresën Nr. 9249/3 Prot., datë 15.11.2023 i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi orientimin e mëtejshëm për procesimin e kërkesës pas refuzimit të subjekteve për vënien në dispozicion të dokumentacionit. Përsa i përket Drejtorisë së Regjistrave Mjedisore Inovacionit dhe Analizave Laboratorike jam njoftuar verbalisht se struktura e tij nuk disponon informacionin e kërkuar.”

Ndodhur në këto kushte, grupi i inspektimit kontaktoi me përfaqësuesen pranë Autoritetit Publik znj. Marjeta Përlala, Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, e cila ka trajtuar praktikën në fjalë, për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Znj. Përlala sqaroi se: *“Qëndrimi i Autoritetit Publik është i njëjtë me atë të dhënë në shkresat e cituara si më sipër nga koordinatori, kjo gjë bazuar mbi Ligjin Nr. 35/2016 për të “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Qëndrimi i mësipërm mbështetet gjithashtu edhe nga përgjigjet e laboratorëve përkatës.”* Për këtë arsye i jemi drejtuar QMM –Qendra e Monitorimit të Mjedisit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.600 prot datë 8.11.2023 protokolluar në AKM me nr. 9249/1 prot 09.11.2023 e cila ka refuzuar dhënien e informacionit. Edhe EKO STUDIO projekt me shkresën Nr.935 prot., datë 14.11.2023 protokolluar në AKM 9249/2 prot datë 14.11.2023 ka refuzuar pëlqimin për dhënien e informacionit. Për arsyet e mësipërme i jemi drejtuar Komisionerit për të Drejtën për Informim me Shkresën Nr. 9243/3 Prot., datë 15.11.2023 që të dali me vlerësim/interpretim në lidhje me situatën e paqartë që jemi hasur, pasi ne nuk kemi refuzuar të japim informacionin.”

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, konfirmuar dhe gjatë inspektimit, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: *“Dhënia e dokumentacionit të kërkuar kufizohet nga shkronja c) e nenit 17 të LDI dhe nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Komisioneri vlerëson se, ky i fundit nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në*

përputhje me dispozitat e ligjit të sipërcituar. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, *“Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”*.

Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesat e ankuesve për t’u informuar nuk çenojnë apo zhveshin autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se: *“Qëndrimi i Autoritetit Publik mbështetet edhe në përgjigjet e laboratorëve përkates, të cilët kanë refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar”*, Komisioneri vlerëson se, ky argument nuk qëndron, pasi, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI, parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative’, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se: *“AKM i është drejtuar Komisionierit mbi orientimin e mëtejshëm për procesimin e kërkesës pas refuzimit të subjekteve për vënien në dispozicion të dokumentacionit”*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

LDI referuar objektit dhe qëllimit të tij *“rregullon të drejtën e publikut për tu njohur me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*.

Ndërkohë, në nenin 17 të LDI parashikohet mundësia e kufizimit të së drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të cojnë autoritetin publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Bazuar në parashikimet e LDI dhe në të gjithë kuadrin rregullator në fushën e të drejtës për informim, është autoriteti publik që bën vlerësimin nëse dokumentacioni/informacioni i kërkuar, i nënshtrohet apo jo kufizimeve të këtij ligji duke iu referuar gjithashtu edhe legjislacionit specifik.

Referuar nenit 9/1 të LDI, në fushën e të drejtës për informim, Zyra e Komisionerit ka kompetencë ndër të tjera, monitorimin e zbatimit të LDI, duke shqyrtuar kërkesat/ankesat e personave, të cilët pretendojnë shkelje të të drejtave të parashikuara në këtë ligj nga ana e autoriteteve publike dhe në rastin konkret Zyra e Komisionerit nuk mund të bëjë vlerësimin mbi një çështje, e cila është ankimuar pranë kësaj zyre dhe është në hetim administrativ. Fakti që, me shkresën nr. 1743/1 Prot., datë 31.10.2023 pas administrimit të ankesës, Komisioneri kërkoi nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së dokumentacionit referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, rrjedhimisht detyrimi mbi vlerësimin e dokumentacionit bie mbi Autoritetin Publik.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Në këtë kuptim, personi përgjegjës duhet të procedoj me vënien në dispozicion të kërkuases të informacionit/dokumentacionit, i cili është prodhuar ose mbahet nga Autoriteti Publik në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit gjatë inspektimit të kryer, Komisioneri konstaton se, znj.Marjeta Përlala, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar në pikën 1 të kërkesës për informacion datë 04.09.2023.

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë*.

Bazuar në pikën 4 të nenit 19, të LDI, *çdo person përgjegjës, i cili me veprimet dhe mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, ka përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të këtij ligji.*

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, e drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Tenius Laboartories Sh.p.k, përfaqësuar nga znj. _____, nr. 1743 Prot., datë 26.10.2023, ndaj Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas pikës 1 të kërkesës për informacion datë 04.09.2023, konkretisht: *(Kopje të raporteve të vetmonitorimit të subjektit Eko Elb sh.a për 5 vitet e fundit)*, brenda datës 28. 12. 2023.
3. Dënimin e znj. Marjeta Përlala, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e

Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.

4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 20. 12. 2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi